



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:225430

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05517486

C.nr.595/17

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike kontestimore të paditëses B.. SH.A, me seli në Prishtinë rruga “.., të cilin e përfaqëson D.., me adresë në Prishtinë, rruga .., kundër të paditurit L.F nga Vushtria, rruga ... me objekt kontesti pagesë e borxhit, me vlerë të kontestit 672.76 euro, në seancën përgatitore të mbajtur me datë 28.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET e tërhequr padia C.nr.595/17 e datës 18.12.2017, e paditësit B.. SH.A, me seli në Prishtinë rruga .., kundër të paditurit L.F nga Vushtria, rruga ... me objekt kontesti pagesë e borxhit, me vlerë të kontestit 672.76 euro.

A r s y e t i m

Paditësi B.. SH.A, me seli në Prishtinë rruga .., të cilin e përfaqëson D.., me adresë në Prishtinë, rruga ..., përmes përfaqësuesit të saj në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurit L.F nga Vushtria, rruga ... me bazë juridike- pagesë e borxhit, me vlerë të kontestit 672.76 euro.

Gjykata me datë 07.03.2024, ka mbajtur seancën përgatitore, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e paditësit, ndërsa ka munguar i padituri L.F, për të cilin ishte konstatuar se gjendet jashtë vendit-Suedi. Me kërkesën e përfaqësues së paditëses, gjykata ka shtyrë seancën për datën 28.03.2024 më fillim në ora 10:00.

Përfaqësuesja e paditësit nuk ka prezantuar në seancën e datës 28.03.2024 dhe mungesën nuk e ka arsyetuar edhe përkundër thirrjes së rregullt me procesverbalin e datës 07.03.2024.

Marr parasysh faktin se në seancë nuk ka prezantuar përfaqësuesja e paditësit dhe mungesën nuk e ka arsyetuar, gjykata bazuar në nenin 409 par.1 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.595/17, me datë 28.03.2024

Gj y q t a r i

Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.